

# Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

UNE JAM NJESOJ SI TI



Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi  
Commissioner for Protection  
from Discrimination



BEST PRACTICES  
IN  
ROMA INTEGRATION  
IN THE WESTERN BALKANS



# Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri

*sipas*

## Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Tiranë, 2013



Kjo broshurë ka për qëllim që të ofrojë informacion për personat që i përka-  
sin një grupi pakice<sup>1</sup>, mbi garancitë dhe mbrojtjen ligjore kundër diskri-  
minimit, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

*Botimi i kësaj broshure është bërë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga  
Diskriminimi me mbështetjen e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike  
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Botimi është realizuar me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit Praktikë më të  
Mira në Integrimin e Romëve, zbatuar nga ODIHR. Pikëpamjet e shprehura  
në këtë broshurë nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të  
Bashkimit Evropian, as politikat dhe pozicionimin e ODIHR.*

Ballina: Rahela Kotollaku, një nxënëse e shkollës “Bajram Curri”, prezantuar në ek-  
spozitën e organizuar në kuadër të projektit “Diskriminimi: Perceptimi dhe sfidat  
aktuale” mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

<sup>1</sup> Termi pakicë është përdorur për të përshkruar grupe rracore, fetare, politike, etnike apo grupe të tjerë të cilët mendo-  
hen të jenë të ndryshëm nga pjesa më e madhe e popullsisë e të cilës ata janë pjesë. Në këtë broshurë termi pakicë  
është përdorur në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar).

## Hyrje

Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm për  
i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen  
dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse  
e të cilave janë dhe të drejtat e pakicave. Këtë fakt e ka dëshmuar gjithashtu  
anëtarësimi i vendit tonë në organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale,  
si dhe ratifikimi apo aderimi në një sërë konventash ndërkombëtare për të  
drejtat e njeriut dhe, në mënyrë të veçantë, në ratifikimin pa asnjë rezervë  
të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Minoriteteve  
Kombëtare”.

Një garanci me shumë për mbrojtjen e pakicave përbën Ligji Nr. 10221 “Për  
mbrojtjen nga diskriminimi”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u  
krijua bazuar në këtë ligj, si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që  
siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që  
nxit diskriminimin.

**Irma Baraku**

*Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi*

1. Çfarë garanton Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi për pakicat në Shqipëri?

Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi garanton të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin pavarësisht përkatësisë në një pakicë.

2. Çfarë është diskriminimi ndaj një ose disa anëtarëve të një pakice?

Me diskriminim ndaj një ose disa anëtarëve të një pakice do të kuptojmë çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, që bazohet në racën, ngjyrën, etninë, gjuhën e një personi ose grupi personash, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të garantuara me ligj.

3. Cilat janë format e diskriminimit ndaj një pakice?

**Diskriminim i drejtpërdrejtë**, ndodh kur një person apo grup personash që i përkasin një pakice, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person apo grup personash tjetër në situatë të njëjta ose të ngjashme.

**Shembull:** Drejtori i një shkolle 9-vjeçare, në shpërndarjen që i ka bërë nxënësve nëpër klasa, ka vendosur që nxënësit romë t'i grupojë në një klasë të veçantë. Kjo përbën veçim për këtë komunitet.

**Diskriminim i tërthortë**, është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash, që i përket një pakice, në kushte jo të favorshme në raport me të tjerët.

**Shembull:** Një institucion çdo vit jep shpërblim për një pjesë të punonjësve

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

për performancë të mirë në punë, por statistikat tregojnë se ky shpërblim asnjë vit nuk ishte marrë nga dy punonjës që i përkisnin një pakice edhe pse performanca ka qenë e njëjtë.

**Udhëzim për të diskriminuar**, është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona që i përkasin një pakice.

**Shembull:** Në një institucion shtetëror ngrihet një komision *ad-hoc* për të realizuar konkursin sipas procedurave për shërbimin civil. Titullari i institucionit i udhëzon në mënyrë konfidenciale anëtarët e komisionit *ad-hoc*, që konkurenti që i përket pakicës greke, të mos vlerësohet me pikë maksimale.

**Shqetësim**, është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me të qenurit pjesë e një pakice, që ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqtësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person.

**Shembull:** Në një lagje një grup fëmijësh të pakicës serbo-malazez, po ofendoheshin me fjalë të pista dhe kërcënuese për prejardhjen e tyre. Kjo solli panik dhe frikë tek fëmijët.

**Diskriminim për shkak të shoqërimit**, është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin një prej pakicave në Shqipëri.

**Shembull:** Në një klasë, vjen një nxënës i ri që i përket një pakice. Albani nxënësi më i mirë i klasës, e mban afër dhe e shoqëron vazhdimisht. Mësuesit filluan t'i ulin vlerësimet Albanit dhe nuk e përfshinin më në aktivitetet kulturore të shkollës, për shkak të shoqërimit me nxënësin që i përket pakicës.

Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme, ndodh kurdoherë kur ka një mohim

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

**Shembull:** Zamira, një vajzë rome me aftësi të kufizuara, çdo të premte zhvillon punë laboratorit, por pasi salla e laboratorit ndodhet në katin e fundit të shkollës ajo asnjëherë nuk ka marrë pjesë në këtë orë mësimi. Ky mosveprim i shkollës për të bërë përshtatjen e ambienteve të shkollës, përbën mohim të përshtatjes së arsyeshme.

**Viktimizimi**, është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.

**Shembull:** Një mësues fillon të sillet keq me nxënësin, pasi ky i fundit është ankuar tek drejtori i shkollës pasi ndihet i diskriminuar për shkak të racës. Sjellja e mësuesit është një reagim ndaj ankimit të nxënësit dhe përbën viktimizim.

### 4. A mund të ndodhë një diskriminim i dyfishtë ose i shumëfishtë ndaj një personi që i përket një pakice?

Po. Një personi që i përket një pakice, mund të jetë njëkohësisht viktimë diskriminimi për një ose disa shkaqe të mbrojtura nga ky ligj.



Shushicë, janar 2013, Aktivitet ndërgjegjësues mbi Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

### 5. A përbën diskriminim për pjesën tjetër të shoqërisë marrja e masave pozitive për pakicat?

Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtatimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të racës, etnisë, gjuhës, ngjyrës, konsiderohet

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Të tilla janë masat për nxitjen e arsimit të fëmijëve romë si: Udhëzim i Ministrit të Arsimit nr.6, dt. 29.03.2006 **“Për Regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”**, ose kuotat e veçanta për nxënësit romë dhe egjiptianë për të ndjekur studimet universitare, udhëzimi për shpërndarjen e teksteve shkollore falas për nxënësit romë..

### 6. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbron pakicat nga:

- Reklamat diskriminuuese;
- Diskriminimi në pjesëmarrjen në politikë; dhe
- Diskriminimi në ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë.



Janar 2013, Përfaqësuesit e Shoqatave Rome dhe Egjiptiane duke bashkëpunuar me Komisioneren për mbrojtje nga Diskriminimi.

### 7. Cilat janë fushat ku Ligji ofron mbrojtje në mënyrë të veçantë?

- Fusha e arsimit;
- Fusha e punësimit; dhe
- Fusha e të mirave dhe shërbimeve.

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

### 8. Si të mbron Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e punësimit?

Ndalohet diskriminimi në fushën e punësimit, që mund t'i bëhet një personi që i përket një prej pakicave, lidhur me gjuhën e përdorur në shpalljen e vendeve të punës, procesin e përzgjedhjes dhe marrjes në punë, trajnimin e punëmarrësve në vendin e punës, dhe zgjidhjen e kontratës, etj.

### 9. A kanë detyrime punëdhënësit për të parandaluar diskriminimin e anëtarëve të një pakice në punë?

Punëdhënësit janë të detyruar të zbatojnë e të nxisin parimin e barazisë, si dhe të ndalojnë çdo lloj sjelljeje diskriminuuese që kryhet në mjedisin e punës. Në rast se konstatohet diskriminimi, punëdhënësi duhet të marrë masa disiplinore për mbrojtjen e punonjësve nga diskriminimi. Në rast se punëdhënësi merr një ankesë për diskriminim, brenda një muaji ai ose ajo është i detyruar t'i përgjigjet asaj.

**Shembull:** Artani është punëmarrës dhe ka 5 vjet që punon në biznesin e Benit. Koleget e Artanit gjatë viteve, janë promovuar në mënyrë të vazhdueshme ndërsa ai jo. Artani i drejton një ankesë Benit, ku i parashtron pretendimet e tij, se është diskriminuar pasi i përket komunitetit Rom. Beni s'e merr në shqyrtim ankesën e tij dhe disa ditë më vonë e pushon dhe nga puna pa i dhënë asnjë shpjegim. Artani ndër disa mundësi zgjedhësh, vendos që t'i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të bërë një ankesë. Punëdhënësi e ka diskriminuar Artanin duke mos trajtuar ankesën për diskriminim dhe duke zgjidhur në mënyrë të paligjshme kontratën e punës.

### 10. Si të mbron Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e arsimit?

Ligji ndalon çdo dallim, kufizim, apo përjashtim lidhur me krijimin e institu-

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

cioneve arsimore, financimin e arsimit trajtimin e nxënësve në lidhje me pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore, ose përjashtimin.

### 11. A ka detyrime drejtuesi i institucionit arsimor për parandalimin e diskriminimit në institucionin e tij ose saj?

Po, ai ose ajo ka një sërë detyrimesh, si: rritjen e ndërgjegjësimit për mosdiskriminim; afishimin e ligjit në mjediset e shkollës, të marrë masa për rastet e diskriminimit, etj.

### 12. Si të mbron Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve?

Personi i cili ofron të mira e shërbime për publikun e gjerë, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë për shkak të përkatësisë së klientit në një pakicë.

**Shembull:** Tre të rinj të komunitetit Rom, nuk lejohen të futen në një lokal nate, me justifikimin se lokali është plot e s'ka vende të lira. Ndërkohë që tre të rinjtë largohen, vënë re se, mbas tyre po lejohen të futen persona të tjerë. Ky rast ilustron diskriminimin dhe përjashtimin nga shërbimi.

### 13. Kush është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Komisioneri është personi juridik publik i pavarur, të cilit i është dhënë autoriteti ligjor për të siguruar garantimin e mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo lloj sjelljeje që nxit diskriminimin.

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

### 14. Cilat janë kompetencat kryesore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi:

- Shqyrton ankesat me pretendim diskriminimin nga personat ose grupet e personave, ose nga organizatat;
- Kryen hetime administrative me iniciativën e tij/ saj pas marrjes së informacionit të besueshëm;
- Vendos sanksione administrative sipas përcaktimit të ligjit;
- Nxiti parimin e barazisë dhe mos-diskriminimit ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave;
- Monitoron zbatimin e këtij ligji;
- Kryen sondazhe në lidhje me diskriminimin;
- Bën rekomandime legjislativë për autoritetet kompetente dhe rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- Përfaqëson ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile;
- Zhvillon aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji etj.

### 15. Si fillon shqyrtimi i një çështjeje diskriminimi?

Përmes ankesës së:

- Një personi
- Një Grupi personash; ose
- Një organizate me interes të ligjshëm



## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit.



Dhjetor 2012, Komunitete në nevojë duke diskutuar mbi çfarë është diskriminimi.

### 16. Ndaj kujt mund të ankohesh për një rast diskriminimi?

Garantohet mbrojtja nga diskriminimi nga çdo veprim ose mosveprim i:

- Personave fizikë;
- Personave juridikë; dhe
- Autoriteteve publike.

### 17. Cilat janë rastet kur nuk pranohet ankesa?

Ankesa nuk pranohet nëse:

- Është anonime;
- Përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e ligjit;
- E njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

- Është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;
- Të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit; dhe
- Paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja e dëmtuari, për këtë fakt.



Ankesa përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është falas. Me qëllim orientimin e subjekteve në faqen zyrtare të Komisionerit, ka një formular ankimi, i cili nuk është i detyrueshëm.

Lezhë, 22 shkurt 2013

### 18. Procedura që ndjek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbas marrjes së ankesës?

Komisioneri

- Verifikon faktet;
- Mund të zhvillojë një seancë dëgjimore publike ku fton palët e interesuara;
- Mund të kërkojë të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa;
- Shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës ose, nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës;
- Mund të urdhërojë rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit;



## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

- Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni;
- Mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit..

### 19. Ku mund të paraqitet një ankesë me pretendim diskriminimi përveç Komisionerit?

Përveç Komisionerit, një ankesë mund të paraqitet:

- Tek drejtuesi i një institucioni arsimor;
- Tek punëdhënësi; dhe
- Në gjykatë.

### 20. Në rast së paraqet një ankesë pranë Komisioneres për Mbrojtje nga Diskriminimi, a mund t'i drejtohesh me kërkesëpadi edhe Gjykatës?

Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim ndër të tjera për shkak të racës, etnisë, gjuhës, ngjyrës, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim. Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës.

## Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

### 21. A ka zyra rajonale ku mund të drejtoj ankesë?

Komisioneri, është institucion kombëtar me qendër në Tiranë. Por, për qytetarët që banojnë në rrethe ka mundësi ankimi duke dërguar ankesën me anë të postës. Gjithashtu, mund të kërkon ndihmë për të kontaktuar me Komisionerin, në bashkitë ose komunat e vendbanimit tuaj, pasi Komisioneri ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa bashki dhe komuna, ndër të tjera edhe për përcjelljen e rasteve me pretendim diskriminimi. Ankesat mund të bëhen edhe nëpërmjet internetit.



Gjirokastrë, 27.11.2012, Foto gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me bashkitë në kuadër të projektit "Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve " zbatuar nga OSBE/ODIHR, financuar nga BE-ja.

## 22. Si mund të kontaktoni me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund ta kontaktoni duke telefonuar, duke dërguar një letër apo një faks, ose duke plotësuar formularin që gjendet në faqen e internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në adresën [www.kmd.al](http://www.kmd.al).

### ADRESA:

**Rr: Sami Frashëri, Nr 10, Kati II, Tiranë**

**Kutia postare 1019**

**Telefon: + 355 4 243 1078**

**Faks: + 355 4 243 1077**

**E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)**

**Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)**

